VENDIM
Nr.549, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 12.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 "Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura", përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 "Masa e shtesës për natyrë të veçantë që përfitojnë ushtarakët në Forcat e Armatosura", e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha